



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivered		20.02.2023	3	viti ggd Year
Organ /Njësia Organ /Zemëra Org /Unit	Nr Prot Bt Prot Prot No	Shtesa Puneg Appendix	Sasia Kohëzma Quantity	
SKPM/SHICK	1913/2023		1/6	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1233/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1133/2022 të datës 21.12.2022, të parashtruar nga ankuesi

kundër

Vendimit KD.nr.07/2022 i datës 18.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 20.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1133/2022 e datës 21.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi KD.nr.07/2022 i datës 18.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje* tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. Obligohet Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datën 19.12.2022 nëpërmjet poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është pranuar me datë 21.12.2022 me numër të protokollit 8259/2022, kundër me Vendimin KD.Nr.07/2022 të datës 18.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit material, shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Drejtësisë, ndërsa Këshilli me datë 20.01.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8259/2022 të parashtruar nga ankuesi me datë 21.12.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 17.10.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesit; Vendimin me numër KD.nr.07/2022 të datës 18.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin e datës 18.10.2022 të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin me numër KD.nr.4/2022 të datës 28.09.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vërtetimin e datës 12.12.2022 të lëshuara nga Policia e Kosovës; Çertifikatën e datës 30.11.2022 lëshuar nga Gjykatat Themelore në Ferizaj-Dega Ferizaj; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.12.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.01.2023; Konkursin e datës 11.05.2011; Akt emërimit e ankuesit të datës 07.08.2012; Kërkesën e datës 19.09.2022 për inicimin e procedurës disiplinore dërguar nga A.A për R.O; E-mailin e datës 19.09.2022 dërguar nga L.B për A.N; Raportin zyrtar me numër:01-826 të datës 29.08.2022 të Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin Nr.32/2022 i datës 03.03.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për themelimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin ZSP-Nr.101/22 i datës 07.09.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për plotësimi ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Vendimin ZSP-Nr.109/22 i datës 23.09.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për plotësimi ndryshimin e vendimit për themelimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 09:00; ; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 14:00; Shkresën me numër refrenece:136/16 e datës 11.11.2016 e titulluar "Informatë"; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 15:00; Procesverbalin e seancës disiplinore të mbajtur nga Komisioni Disiplinor me datë 13.10.2022 në ora 14:30; E-mailin e datës 18.01.2023 dërguar nga R.O për A.N; E-mailin e datës 11.10.2022 dërguar nga G.N për R.O; E-mailin e datës 10.10.2022 dërguar nga R.O për G.N.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda e ankuesit _____ të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje*, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shkresat e administruara të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi _____ sipas Aktit të Emërimit të datës 07.08.2012 mban pozitën e punës "*Kryeinspektor i Inspektoratit*" në kuadër të Divizionit: Inspektorati për Inspektimin e Punës në SHKK pranë Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa ndaj të njëjtit Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë me datë 19.09.2022 ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore për shkak të shkeljeve disiplinore të gjetura në Raportin Zyrtar të datës 29.08.2022 të përgatitur inspektorët M.B, Z.S dhe J.K sipas kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë.

Po ashtu, sipas shkresës me numër:01-826/2 të datës 19.09.2022 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ka proceduar kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore tek Kryesuesi i Komisionit Disiplinor, ndërsa Komisioni Disiplinor me datë 28.09.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.4/22 përmes të cilit ankuesi është pezulluar përkohësisht nga puna prej datës 28.09.2022. Tutje, me datën 18.10.2022 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, ka nxjerrë Vendimin me numër:01-826/3, sipas të cilit e ka shtyrë afatin fillestar për vendosjen e procedurës disiplinore ndaj ankuesit edhe për tridhjetë (30) ditë, ndërsa pas kësaj me datën 18.11.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër KD.nr.07/2022 sipas së cilit e ka pezulluar tërësisht procedurën disiplinore ndaj ankuesit duke u thirrur në nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 55, 56 dhe 58 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me arsyetimin se ndaj tij është hapur rast në Prokurori përkatëse dhe mbi këtë bazë ka vendosur lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore deri në vendosjen e çështjes kryesore nga organi kompetent.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit sa i përket çështjes së pezullimit nga puna në afat të papërcaktuar nga ana e Komisionit Disiplinor, ka analizuar dispozitat ligjore mbi bazën e të cilave është nxjerrë vendimi i kontestuar dhe ka vlerësuar se neni 55 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: "*1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, i cili bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; apo 1.2. me kërkesë të nëpunësit civil*", po ashtu neni 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: "*1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 5 të nenit 48 të këtij ligji*", ndërsa neni 48 paragrafi 5 i të njëjtit ligj përcakton se: "*Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedurë disiplinore, pengon hetimin disiplinor apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar*", andaj duke iu referuar akteve normative të lartcekura, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit arrihet në përfundimin se Komisioni Disiplinor ka diskrecion që të pezullojë nga puna nëpunësin civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore, mirëpo vetëm për periudhën kohore sa zhvillohet procedura disiplinore, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit përfundimtar, nga rrjedh se kuptimi i kësaj norme ndërlidhet me përfundimin e procedurës disiplinore dhe vendimmarrjen brenda afateve të përcaktuara kohore siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 6 të Rregullores (QRK)

Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë: *“Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore.”*, shtuar faktin kësaj edhe vazhdimin të afatit fillestar edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera në kuptim të nenit 99 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj nisur nga dispozitat ligjore të analizuara si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Drejtësisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.07/2022 të datës 18.11.2022 lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore për rastin e ankuesit, nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, ngase përveçse e ka pezulluar procedurën disiplinore të iniciuar sipas kërkesës së datës së datës 19.09.2022 e ka lënë në fuqi edhe vendimin paraprak të datë 28.09.2022 me numër KD.nr.4/2022 për pezullim të përkohshëm nga puna me kompensimin prej 50% të pagës, kur dihet fakti se në kuptim të nenit 58 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *“4. Nëpunësi civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1.1 të nenit 56, në rast se procedura përfundon pa një masë disiplinore”*, nga rrjedh se sipas kësaj logjike vendimmarrëse ankuesi duhet të kompensohet plotësisht gjatë periudhës kohore përderisa Komisioni Disiplinor e ka pezulluar komplet procedurën disiplinore pa shqiptim të masës disiplinore, dhe kjo krijonë situatë të pasigurisë juridike dhe keq menaxhimit, çështje të cilën normat e ligjit material e kanë rregulluar krejt ndryshe, gjegjësisht Komisioni Disiplinor me rastin e pezullimit të procedurës disiplinore duke e mbajtur ankuesin edhe të pezulluar nga punë njëkohësisht, ka dal përtej mandatit dhe kompetencave të tyre ligjore, ngase në kuptim të nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil pezullohet, sipas detyrës zyrtare të organit përkatës të punëdhënësit, në rastet si në vijim: 1.4. kur gjykata vendos ndaj nëpunësit civil si masë parandaluese penale pezullimin e ushtrimit të detyrës apo shërbimit publik, sipas ligjit në fuqi”* vetëm Gjykatës i është njohur ligjërisht kjo e drejtë apo kompetencë që ndaj nëpunësit civil mund të vendos masë parandaluese penale me qëllim të pezullimit të ushtrimit të detyrës zyrtare, deri në vendosjen meritore.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se çështja e institutit të pezullimit të marrëdhënies së punës e rregulluar me nenin 56 të i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ka përcaktuar nëntë (9) raste kur nëpunësit civil mund të pezullohen nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare, dhe nga të gjitha këto vetëm për një (1) rast i është rezervuar e drejta diskrecionale Komisionit Disiplinor që të pezullojë nëpunësin civil sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht në rastet kur ndaj të njëjtit hapet apo iniciohet procedurë disiplinore nga Komisioni Disiplinor, mirëpo vetëm deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar që zgjidh çështjen juridike brenda afateve kohore të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se Vendimi me numër KD.nr.07/2022 i datës 18.11.2022 i Komisionit Disiplinor nuk është vendim përfundimtar në procedurë administrative, ngase përmes të njëjtit nuk është zgjedhur çështja juridike e iniciuara sipas kërkesës së datës 19.09.2022 për inicimin e procedurës disiplinore, gjegjësisht me vendimin e njëjtë nuk është konfirmuar nëse ankuesi ka kryer shkelje disiplinore apo jo.

Po ashtu, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor me rastin e pezullimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, duke u bazuar vetëm në e-mailin e datës 11.10.2022 dërguar nga G.N shefi i kabinetit të ministres për Kryesuesin e Komisionit Disiplinor me përbujtjen se: *"..... është përcjellë raporti në zyrën e Prokurorit të Shtetit dhe pastaj zyra e Prokurorit kanë informua që për shkak të kompetencës, të njëjtën e kanë proceduar në Prokurori Speciale",* është i paqëndrueshëm ligjërisht ngase në rastin konkret shefi i kabinetit së ministres nuk e përfaqëson apo nuk ka kompetencë ligjore që të përgjigjet në emër të prokurorisë apo të konstatojë zyrtarisht veprimet procedurale të prokurorisë pa bashkangjitur asnjë shkresë zyrtare të institucioneve respektive të ndjekjes penale, ndërsa Këshilli në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.12.2022, kishte kërkuar nga Ministria e Drejtësisë provat relevante për rastin me theksin e veçantë që: *"Dëshmi me shkrim mbi bazën e të cilave është mbështet nxjerrja e vendimit KD.nr.07/2022 nga Komisioni Disiplinor me datë 18.11.2022 (shkresat e përcjella në Prokurorinë përkatëse)",* ndërsa kjo e fundit në cilësi të kësaj prova ka sjellë vetëm e-mailin e lartcekur, nga rrjedh se në rastin konkret nuk është përmbushur apo nuk është dëshmuar me prova relevante përmbushja e kriterit ligjor të përcaktuar me nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me pezullimin e procedurës disiplinore, përderisa ankuesi në cilësi të provave mbështetëse të pretendimet ankimor ka sjell Vërtetimin e datës 12.12.2022 të Policisë së Kosovës si dhe Çertifikatën me shifër PN.NR.KR.BR/1007/22 të datës 30.11.2022 lëshuar nga Gjykatat Themelore në Ferizaj, mbi bazën e të cilave dëshmohet se i njëjti nuk ka dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës, sikurse ndaj të njëjti nuk është duke u zhvilluar procedurë penal dhe as nuk është i dënuar.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.037/2022 të datës 18.11.2022 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material si dhe kompetencat e përcaktuara me nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe si i tillë është i palosshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe mbi këtë bazë i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që një çështje e tillë nuk mund të përliqjet.

Andaj, duke qenë se Vendimi me numër KD.nr.07/2022 i datës 18.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj rastin e ankuesit lidhur me inicimin e procedurës disiplinore dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh pikëpamjet juridike dhe vërejtje të dhëna nga Kolegji i Këshillit sikurse në arsyetimin e këtij vendimi.

Keshtu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1233/2022

Flakron GASHI

Zyrtarë e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë, dhe
- Arkivitet të KPM SHCK-së.